



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura III**  
**Sesioni Pranveror**

---

Komisioni për Punë të Jashtme  
Mbledhja nr. 29  
Prishtinë, më 20. 01. 2010, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

## **P r o c e s v e r b a l**

### **I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Enis Kervan, Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Ardian Gjini dhe Slobodan Petroviq.

**Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit ishin:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

### **R E N D I I D I T Ë S**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 4 nëntor 2009;**
- 3. Shqyrtimi i Raporti të punës së Komisionit për vitin 2009;**
- 4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare;**
- 5. Të ndryshme.**

**1. Miratohet rendi i ditës**

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**

*Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua njëzëri.*

**3. Shqyrtimi i Raporti të punës së Komisionit për vitin 2009;**

**Sabri Hamiti** – Lidhur me Raportin për punën e Komisionit për vitin 2009, tha se është shpërndarë një Drafraporti që pasqyron punën e Komisionit gjatë vitit 2009.

Pas shqyrtimit të Raportit të punës së Komisionit për vitin 2009, Komisioni nxori këtë

### **P ë r f u n d i m**

Miratohet njëzëri Raporti i punës së Komisionit për vitin 2009.

#### **4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare**

**Sabri Hamiti** – Tha se Projektligji për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare së shpejti do të radhitet për miratim në seancë plenare për lexim të parë.

Komisionet funksionale e kanë mundësinë e shqyrtimit të Projektligjit edhe para leximit të parë në seancë plenare, prandaj edhe është paraparë shqyrtimi i tij në këtë mbledhje.

Propozoi të formohet grupi i punës prej tre anëtarësh që ta shqyrtojë Projektligjin për ta dhënë mendimin e Komisionit për të, gjatë leximit të parë, si dhe pastaj të vazhdojë me nevojën amendamentimit të këtij projektligji. Anëtarë të grupit të punës propozoi:

1. Ibrahim Gashi, raportues,
2. Lutfi Haziri dhe
3. Ardian Gjini.

**Ardian Gjini** - Tha se nuk mund të jetë anëtar i këtij grupi të punës, pasi që nuk e përkrah këtë projektligj, sepse është proceduar pa respektuar radhën nga Qeveria.

**Sabri Hamiti** - Propozoi anëtar të tretë të grupit të punës deputetin Enis Kervan.

Komisioni pas diskutimeve nxori këtë

### **P ë r f u n d i m**

Formohet grupi i punës në përbërje: Ibrahim Gashi, raportues, Lutfi Haziri dhe Enis Kervan, anëtarë, për dhënien e mendimit në emër të Komisionit gjatë leximit të parë në seancë plenare të Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, si dhe për nevojën e amendamentimit të tij në procedurën e mëtutjeshme.

#### **5. Të ndryshme.**

**Sabri Hamiti** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se në mbledhjen e ardhshme do të hartohet Plani i punës së Komisionit, për të cilin ekziston një draft fillestar.

**Ibrahim Gashi** - Tha se duhet kërkuar mendimin e Ministrisë së Jashtme, përderisa thuhet se nuk do të ketë përzgjedhje të diplomatëve përmes konkursit, ndërsa nuk është i paraparë amendamenti i Ligjit për shërbimin diplomatik në Strategjinë Legjislative të Qeverisë.

**Sabri Hamiti** - Tha se është miratuar iniciativa për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për shërbimin diplomatik.

**Ardian Gjini** – Shtoi se në Strategjinë Legjislative të Qeverisë nuk figuron plotësimi dhe ndryshimi i këtij ligji.

**Xhavit Haliti** - Propozoi që të kërkohet nga Ministria e Punëve të Jashtme lista e gjithë personelit të ambasadave së bashku me CV- të e tyre, që të jemi të njoftuar për personalitetet që punojnë atje dhe problemet që mund t'i kenë.

**Sabri Hamiti** - Propozoi të ftohet në mbledhje të Komisionit përfaqësuesi i Ministrisë që të njoftojë për funksionimin e shërbimit diplomatik jashtë, si dhe të kërkojmë listat me CV - të e personelit nëpër ambasada.

**Ibrahim Gashi** - Përkrah propozimin që të ftohet Ministri në mbledhje dhe të raportojë se deri në ç' masë është bërë konsolidimi i ambasadave.

**Ardian Gjini** - Propozoi që me rastin e ftesës së ministrit në mbledhje të Komisionit të diskutohet edhe për temën rreth angazhimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme, për njohjet edhe nga pesë shtetet e BE - së.

Komisioni pas këtyre diskutimeve nxori këtë

### **P e r f u n d i m**

1. Të ftohet ministri i jashtëm, z. Skënder Hyseni, që të raportojë për nivelin e konsolidimit dhe funksionimit të shërbimit diplomatik të Kosovës, si dhe për angazhimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për njohjet edhe nga pesë shtetet anëtare të BE - së.
2. Të kërkohen nga Ministria e Punëve të Jashtme lista e personelit të shërbimit diplomatik së bashku me CV- të e tyre.

Mbledhja përfundoi në orën 10: 30

Kryetari i Komisionit

---

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetje të Komisionit